

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi të enjten me 17 pika në rend dite, nga interpelancat te ndryshimet për pagat e magjistratëve
ADRESA	https://albeu.com/lajme/kuvendi-te-enjten-me-17-pika-ne-rend-dite-nga-interpelancat-te-n-dryshimet-per-pagat-e-magjistrateve/1013041/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:10:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:07:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	18b552bf1560cbb15d9e9d133588af5ab22433128404449240c2195e687c7fde
TEKSTI	da8f8b323cc08b466f010f29622f38a5edf19a72bb9b53284287cc784ab7fc11
PAMJA	3a416f90f370e60f3ab3933e522f20caa5c611597bee43fa1e52b739d8cfaa4e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	19399f45501bd7ae6e96b731a37753a3500462109a0d4a80b4aec38f38545134
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcddc39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/19399f45501bd7ae6e96b731a37753a3500462109a0d4a80b4aec38f38545134>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kuvendi të enjten me 17 pika në rend dite, nga interpelancat te ndryshimet për pagat e magistratëve



Seanca plenare e Kuvendit të enjten do të nisë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së 8 shtatorit 2026 dhe me njoftimet përkatëse. Në vijim, deputetët do të shqyrtojnë një sërë interpelancash urgjente me ministra të qeverisë, projektligje dhe projektvendime.

Katër interpelanca urgjente janë kërkuar nga deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ndërsa një interpelancë tjetër është paraqitur nga deputeti Blendi Himçi.

Rendi i ditës përfshin çështje që lidhen me Ukrainën, inteligjencën artificiale, sektorin e ullirit, statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, disenjot, shoqëritë me ofertë publike, si dhe përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 8 shtator 2026.
2. Njoftime.
3. Interpelancë urgjente me Ministrin e Mjedisit, Sofjan Jaupaj, e kërkuar nga një grup deputetësh i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
4. Interpelancë urgjente me Ministrin e Punëve të Brendshme, e kërkuar nga një grup deputetësh i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
5. Interpelancë urgjente me Ministren e Arsimit, Mirela Kumbaro, e kërkuar nga një grup deputetësh i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
6. Interpelancë urgjente me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahiu, e kërkuar nga

të fundit /



Dinamo zyrtarizon afrimin e Saliu Sembenes, ...



SHBA pranon se ka armë në orbitë, shtohen shqetësimet për një ...



Bardhi: Akuzat ndaj Ballukut janë rënduar, SPAK po i lë kohë ...



Kurti cakton zëvendësministret e rinj në Qeverinë e Kosovës



De Rossi ndryshon qëndrim për Mario Mitajn, mbrojtësi ...



Ekskluzive: Dion Kacuri zgjedh Kosovën dhe merr ftesë për Ligën ...



Pamje të pazakonta, mafia italiane zhvillon garë të paligjshme ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

nje grup deputetesn i Grupit Parlamentar te Partise Demokratike.

7. Interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, e kërkuar nga deputeti Blendi Himçi.

8. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, bërë në Hagë, më 16.12.2025". Pas pyetjeve do të paraqitet qëndrimi i nismëtarit dhe i Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Mendimet e tyre do t'i japin edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Në vijim do të flasin grupet parlamentare dhe projektligji do të votohet.

9. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës". Pas pyetjeve do të dëgjohen nismëtarit dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik. Mendime do të paraqesin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme, përpara diskutimit të grupeve parlamentare dhe votimit.

10. Shqyrtimi i projektligjit "Për pranimin e vendimit DEC-I 1/119-VI/2024, të Këshillit të Anëtarëve të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, për ndryshimin e nenit 36 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinj të Tavolinës, 2015, aderuar me ligjin nr. 112/2017". Për nismën do të shprehen nismëtarit dhe Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural. Mendim do të japin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Pas diskutimit do të bëhet votimi.

11. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar". Procesi do të vijojë me pyetje, qëndrimin e nismëtarit dhe atë të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik do të paraqesin mendimet e tyre, më pas do të zhvillohen diskutimet dhe votimi.

12. Shqyrtimi i projektligjit "Për disenjot". Pas pyetjeve dhe qëndrimit të nismëtarit, do të flasë Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. Mendime do të japin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Në përfundim do të zhvillohen diskutimi dhe votimi.

13. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10236, datë 18.2.2010, 'Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike'". Pas pyetjeve dhe paraqitjes së qëndrimit të nismëtarit, çështja do të trajtohet nga Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. Mendim do të japin Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme. Më pas do të bëhen diskutimet dhe votimi.

14. Shqyrtimi i projektvendimit "Për disa ndryshime në vendimin nr. 85/2026, 'Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit'". Projektvendimi do të hidhet në votim.

15. Shqyrtimi i projektvendimit "Për disa ndryshime në vendimin nr. 86/2026, 'Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit'". Edhe kjo pikë do të kalojë drejtpërdrejt për votim.

16. Shqyrtimi i projektvendimit "Për disa ndryshime në vendimin nr. 87/2026, 'Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit'". Votimi do të kryhet me shumicë të thjeshtë.

17. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

Gjatë diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës, çdo deputet do të ketë në dispozicion jo më shumë se 5 minuta. Kur fjala merret në emër të një grupi parlamentar, koha maksimale është 8 minuta. Në total, kjo pikë nuk mund të zgjasë më shumë se 60 minuta.

Shtuar më 15.09.2026 19:07

Tags: -Politikë , Enjte , kryesorë , kuvendi ,
Lajmet e fundit , rendi i dites , Shqipëria , Të Gjitha





Projektligji i PS për rritjen e pagave të magistratëve, gjyqtari Gerd Hoxha: Në...



Spartak Ngjela: SPAK nuk vepron pa prova, mbështetja ndërkombëtar...



Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon kryeministri Rama



Përplasja në Komisionin e Ligjeve, Korreshi i përgjigjet Gogut për "barsoletën" d...



Moderatori Bledi Strakosha tregon betejën e vështirë shëndetësore: Brenda dit...



Goditet banda shqiptare e kokainës në Belgjikë, 8 të arrestuar, mes tyre Gert...



GJKKO refuzon ndryshimin e masës së sigurisë për Ilir Metën, ai vijon të qëndroj...



Gazment Bardhi kundërshton ashpër nismën për pagat e magistratëve...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.